



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Prilje/Prodato Received/Delivered	28.10.2022	2 viti god year	
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPK/MSHCK	6530/2022		1/8



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.755/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.755/2022 të datës 01.09.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ përmes përfaqësuesit, Avokatit _____ me adresë: _____ në Prishtinë, kundër Vendimit me numër:5485 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë i datës 02.08.2022 në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.755/2022 e datës 01.09.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër:5485 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë i datës 02.08.2022.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Sekretari i Përgjithshëm me datë 27.04.2021 ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të

detyrave të punës, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 25.05.2022 ka nxjerrë vendimin me numër protokolli: 4494 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil". Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisioni Disiplinor, në pajtim me dispozita ligjore në fuqi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 22.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Më datë 06.07.2021 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës e cila është protokolluar me numër 3471/2021.

Anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2021 i kishte shkarkuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa, Këshilli e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1963/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 05.08.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 22.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.07.2022 përmes Vendimit me numër A.nr.582/2021 dhe numër protokolli:4157/2022 e kishte shfuqizuar Vendimin e Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës 25.05.2021 me numër protokolli:4497 dhe lëndën e kishte kthyer në ri-shqyrtim dhe rivendosje për shkak të metave ligjore të aktit të ankimuar dhe si pasojë nuk kishte mundur të konstatojnë faktin nëse ankuesi kishte kryer apo jo shkelje të rënda disiplinore, ndërsa e Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas ri-shqyrtimit të rastit të ankuesit me datë 02.08.2022 ka nxjerrë vendimin më numër protokolli:5485 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Ankuesi kundër vendimit të datës 02.08.2022 më numër protokolli:5485 të Komisionit Disiplinor ka parashtruar ankesë me datë 01.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Komisionit Disiplinor nuk ka marrë për bazë vërejtjet e dhëna në Vendimin e datës 15.07.2022 me numër A.nr.582/2021, po ashtu procedura është përcjellë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, shkelje të

dispozitive të ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 13.10.2022 Kryetari i këshillit ka nxjerrë vendimin me numër VK.nr.120/2022 përmes të cilit, ankesës A.nr.755/2022 të datës 01.09.2022 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për 10 (dhjetë) ditë punë, për shkak të specifikave të lëndës dhe nevojës për shqyrtime shtesë nga ana e Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.06.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.15/33 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 28.02.2018; E-mailin e datës 16.03.2016 dërguar nga F. B për M.G me shkresat e bashkangjitura dhe korrespondencën prej 19 faqesh; Kërkesën e datës 27.04.2021 me numër prot:3627; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër A.A.nr.2/21 të datës 14.01.2021; E-mailin e datës 09.10.2020 dërguar nga B. K për ankuesin; Autorizimin e datës 25.05.2021; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.06.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.07.2021 me numër:2585-2/21 e pranuar në Këshill me datë 06.07.2021 me të gjitha shkresat e lëndës; Vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë i datës 25.05.2021 me numër protokoli:4497; Aktgjykimit A.nr.1963/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Njoftimin e datës 05.08.2021; vendimin e Këshillit A.nr.582/2021 të datës 15.07.2022; Vendimi me numër:5485 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë i datës 02.08.2022; E-mail i dërguar nga R.M drejtuar F.B e datës 30.01.2019 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-5 faqe; E-mail i dërguar nga F.B drejtuar A.C e datës 06.05.2019 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-7 faqe; Shkresë- Kronologji lidhur me angazhimet e UD-së për aktivitetin e paraparë me planin e punës 2016- Regjistri i pronave ujore me tabelën e bashkangjitur të regjistrit të pronave ujore; Vendim- Leje ujore për HC-Lumbardhi II me nr.prot.5058/20 e datës 03.02.2021; Leje ujore nr.L.U.7 e datës 01.02.2021; Vendim - Leje Ujore me nr. Prot 5475-2/20 e datës 11.02.2021; Vendim i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Nr.L.U.11 e datës 09.02.2021; Vendim - Leje Ujore për HC- Belaje me nr.prot.4981-2/20 e datës 04.11.2020; Leje ujore nr.L.U.13 e datës 03.11.2020; Vendim - Leje Ujore për HC-Deçani nr. Prot.4982-2/20 e datës 04.11.2020; Leje ujore nr.L.U.14 e datës 04.11.2020; Vendim - Leje Ujore për HC- Orçusha nr.prot.6113-3/19 e datës 18.09.2020; Vendim Nr.L2 e datës 17.09.2020; Shkresa me numër 3499 e datës 20.07.2020 përmbajtja e së cilës është e pa identifikueshme me Vendimin e bashkangjitur i cili po ashtu është i pa identifikueshëm; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar H.K e datës 20.05.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; Aplikacioni për kushtet ujore me nr.prot.7008/19 e datës 03.12.2019; E- mail i dërguar nga drejtuar e datës 19.05.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; Mostër e raportit të shqyrtimit të aplikacioneve për akte ujore me nr.prot.5589/20 e datës 16.12.2020 me mbishkrimin "ARIL" prej 1-6 faqe; Shqyrtim i aplikacionit për akte ujore me mbishkrimin "AGJK" prej 1-4 faqe; Mostër e raportit të shqyrtimit të aplikacioneve për akte ujore me mbishkrimin "ARIL" prej 1-6 faqe; Përshkrimi i dizajnit dhe parametrave të prodhimit të HEC

Lumbardhiu II I DATËS Nëntor 2020 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-5 faqe; E- mail i dërguar prej G.B drejtuar H.K i datës 19.05.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-6 faqe; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar H.K e datës 19.05.2021; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar H.K e datës 19.05.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-8 faqe; Shkresë me mbishkrimin "Kronologji për kompaninë" me tabelën e bashkangjitur prej 1-4 faqe; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar H.K e datës 18.05.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1- 2 faqe; E- mail i dërguar nga F.B drejtuar A.T e datës 06.05.2019 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-12 faqe; Raport përfundimtar i grupit punës Ministror për Verifikimin dhe finalizimin e bazës së të dhënave lidhur me lejet ujore, pagesat dhe obligimet e mbetura e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Departamenti i Ujrave e datës 17.03.2016 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-22; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar F.Q e datës 15.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-20 faqe; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U.K. " Bifurkacioni" SH.A dhe MMPH-së me nr prot.5420/18 e datës 21.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Hidrodrini" SH.A dhe MMPH-së me nr prot5426/18 e datës 21.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. " Hidroregjioni jugor" SH.A dhe MMPH-së me nr prot5397/18 e datës 20.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Hidrosistemi Gjakova" SH.A dhe MMPH-së me nr prot.5385/18 e datës 20.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Hidromorava" SH.A dhe MMPH-së me nr.prot. 5358/18 e datës 19.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes N.H. "Ibër-Lepenc" SH.A dhe MMPH-së me nr.prot.5368/18 e datës 19.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Prishtina" SH.A dhe MMPH-së me nr.prot.5389/18 e datës 20.09.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Radoniqi- Dukagjini" SH.A dhe MMPH-së me nr.prot.6110/18 e datës 22.10.2018; Marrëveshje për programimin e borxhit mes K.R.U. "Drini i Bardhë" SH.A dhe MMPH-së me nr.prot.5467/18 e datës 24.09.2018 me tabelën e bashkangjitur; Procsverbal i Komisionit Disiplinor i datës 21.05.2021; Procsverbal i Komisionit Disiplinor i datës 24.05.2021; Procesverbal i Komisionit Disiplinor me numër 4494/2021 i datës 25.05.2021; Vendim i lëshuar nga Ministria Infrastrukturës me nr.prot.5238 e datës 05.06.2018; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit ipër A.S i datës 14.09.2016; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për M.G e datës 05.02.2016; E- mail i dërguar nga C.D drejtuar M.G e datës 25.01.2016; Vendim Sekretariatit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me nr.prot.3575 i datës23.04.2021; Plotësim i kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore nr.prot. 3751 e datës 30.04.2021; Kërkesë për veprim me nr.prot.3627e datës 27.04.2021; Pjesë e Raportit Kombëtar të Auditimit për vitin 2019 prej 1-4 faqe; Pjesë e Raportit Kombëtar të Auditimit për vitin 2017 prej 1-3 faqe; Pjesë e Raportit Kombëtar të Auditimit për vitin 2018 prej 1-3 faqe; Raporti i Auditimit- Shërbime Sigurie me nr.prot.520/21 e datës 08.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur" Auditim-Shërbime Sigurie, Rasti " Union Aqua"; E-mail i dërguar nga M.M drejtuar F.Q e datës 21.12.2020; E- mail i dërguar nga M.M drejtuar G.B e datës 11.01.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1- 2 faqe; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar B.Te datës 01.02.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar M.M e datës 11.01.2021me korrespondencën e bashkangjitur-Foto; E-mail i dërguar nga M.M drejtuar F.Q e datës 21.12.2021; E- mail i dërguar nga G.B drejtuar F.Q e datës 23.12.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; E-mail i dërguar nga G.B drejtuar M.M, SH.D, H.H, F.B, F.B. me korrespondencën e

bashkangjitur prej 1-5 faqe; E-mail i dërguar G.B drejtuar M.M i datës 02.11.2020 E-mail i dërguar nga F.Q drejtuar M.M i datës 03.12.2020; E-mail i dërguar nga H.H drejtuar M.M, SH.D,F.B,F.B e datës 07.12.2020; Raporti i Komisionit lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit Investivo-Teknik të lëndës me nr. Të protokollit 5088/20, për HEC " LUMBARDHI' 2 të Kelkos Energy sh.p.k., Lumi Deçan, Komuna e Deçanit e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e datës 07.15.2020; Raporti i Komisionit lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit Investivo-Teknik të lëndës me nr. Të protokollit 5088/20, për HEC " LUMBARDHI' 2 të Kelkos Energy sh.p.k., Lumi Deçan, Komuna e Deçanit e lëshuar nga Komisioni i datës 07.12.2020; Vendim i Sekretariatit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit me nr.prot.5088-2/20 e datat 24.11.2020; E-mail i dërguar nga F.Q. drejtuar M.M e datës 03.12.2020; E-mail i dërguar nga H.H drejtuar M.M, SH.D., F.B.,F.B, e datës 04.12.2020 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; E-mail i dërguar nga H.H drejtuar M.M, SH.D., F.B.,F.B., e datës 07.12.2020; E-mail i dërguar nga F.B drejtuar H.H.,M.M, SH.D., F.B i datës 07.12.2020 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; E-mail i dërguar nga M.D drejtuar M.M e datës 23.04.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-2 faqe; E-mail i dërguar nga M.D drejtuar M.M e datës 23.04.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-9 faqe; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 23.05.2019 prej 1-4 faqe; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit për G.B i datës 28.05.2020; Ankesën e ankuesit të datës 01.09.2022 të parashtruar në Këshill e protokolluar me numër:5061/2022; Vendimin e Kryetarit të këshillit i datës 13.10.2022

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit Aktit të Emërimit të datës 28.05.2020 mban pozitën "Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore" në Departamentin e Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, ndërsa të njëjtit sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 27.04.2021 e plotësuar më shkresën e datës 30.04.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisioni Disiplinor përmes Vendimit të datës 02.08.2022 me numër protokollit:5485 me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit, të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" me arsyetimin se i njëjti ka bërë shkelje të rënda disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.7 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02.08.2022 me numër protokollit:5485 ankuesin e ka gjetur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore me arsyetimin se ankuesi në cilësi të Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte nuk i ka ndërmarr veprimet e nevojshme sipas të gjeturave të Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 lidhur me inkasimin e borxheve të grumbulluara nga kompanitë: KRU "Prishtina" në vlerë 95,322.10€; KRU "Radoniqi-Dukagjini" në vlerë 31,022.24€ dhe KRU "Drini i Bardhë" 2,610.00€ të cilat nuk i kishin shlyer borxhin sipas marrëveshjeve paraprake, duke i shkaktuar kështu dëm buxhetit të Ministrisë në vlerë të përgjithshme prej 128,954€, po ashtu ankuesi është gjetur përgjegjës për

shkak të mos trajtimit brenda afatit të përcaktuar me nenin 98 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të kërkesës së datës 03.12.2019 të parashtruar nga operatori ekonomik "Ujë Rugove" SHPK, nxjerrja e Vendimit financiar të datës 29.07.2020 me numër 3499/20 nga ana e ankuesit përmes të cilit operatorit ekonomik "Unior Aqua" D.O.O i është mundësuar shfrytëzimi i ujit është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Rregullores Nr.05/2017 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës të MMPH pasi që nuk kishte të emëruar komision paraprak nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, respektivisht ankuesi ka qenë edhe shqyrtues i kërkesës edhe vendimmarrës i së njëjtës, po ashtu ankuesi është gjetur përgjegjës lidhur me lejet e lëshuara me rekomandim të Autoritetit të Pellgjeve Lumore për HC "Lumbardhi II" për operatorin ekonomik "Kelkos Energy" SHPK të datës 03.02.2021 me numër prot.5058/20, HC "Sharri" i datës 11.02.2021 me numër prot:547-2/20 për operatorin ekonomik "Matkos Group" SHPK, HC "Belaje" për "Kelkos Energy" SHPK të datës 04.11.2020 me numër prot:4981-2/20, HC "Deçani" për operatorin ekonomik për "Kelkos Energy" SHPK të datës 04.11.2020 me nr. Prot: 4982-2/20, HC "Orçusha" për operatorin Ekonomik NPN "Renelual Tahiri" SHPK të datës 18.09.2020 me numër prot: 6113-3/19 janë dhënë në kundërshtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, sikurse edhe rasti i lejes ujore të datës 03.02.2021 me numër prot: 5058/20 e përgatitur nga ankuesi për HC "Lumbardhi II" të "Kelkos Energy" është bërë pa rekomandimin e zyrtares së lartë për të drejtën ujore ndërsa rekomandimi i dhënë nga ankuesi është në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e ligjit material, respektivisht nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmi",* po ashtu ka analizuar edhe nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.7 dhe 3.10 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi"* dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit dhe shqiptimit të masës disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"* përmes Vendimit të datës 02.08.2022 me numër 5785 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të ligjit material, pasi që ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase ankuesi me rastin e veprimit apo mosveprimet për shkeljet e konstatuara si më lart ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës, veprime këto të cilat kanë konsumuar elementet e përgjegjësive disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht e bëjnë ankuesin përgjegjës për shkeljet e përcaktuara si në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.7 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se vendimi i ankimuar në Këshill, gjegjësisht Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 02.08.2022 përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 48 dhe 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa nuk janë evidentuar lëshime në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të cilat do të bënin të paligjshëm aktin e kontestuar, po ashtu masa e shqiptuar disiplinore është në proporcion me shkeljen e kryer ngase nga administrimi i prova të lëndës vërehet fakti se ankuesi i kishte përsërit të njëjtat veprime për disa raste dhe në vazhdimësi, ndërsa në kuptim të nenit 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, Komisioni disiplinor ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencën dhe autorizimet ligjore që ka, pasi që për shqiptimin e masave disiplinore të përcaktuara me neni 47 paragrafi 1 në paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 është përgjegjës dhe kompetent Komisioni Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit sipas Vendimit të Këshillit me numër A.nr.582/2021 të datës 15.07.2022 nuk i ka marr për bazë vërejtjen e dhëna, janë të paqëndrueshme ngase Kolegji i Këshillit me rastin e trajtimit të vendimit paraprak të Komisionit Disiplinor të datës 25.05.2021 me numër protokolli:4497 të cilin e kishte shfuqizuar dhe lëndën e kishte kthyer në rivendosje, ka qenë për shkak të metave të tij ligjore ngase Kolegji i Këshillit e ka pasur të pamundur të lëshohet në shqyrtimin thelbësor të rastit nëse ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, apo nëse masa e shqiptuar disiplinore ka qenë në proporcion me shkeljen e supozuar, ngase Komisioni Disiplinor iu ishte referuar dispozitave ligjore të dy ligjeve materiale të cilat janë përjashtuese ndaj njëri tjetrit ngase kanë prodhuar efekte juridike në kohë të ndryshme, sikurse i mungonte edhe konstatimi i saktë si cilën nga përcaktimet e shkeljeve të rënda disiplinore e kishte konsumuar ankuesi me veprimet apo mos veprimet e tij të përcaktuara sipas nenit 46 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore sikurse edhe analizimit të vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 02.08.2022 në kuptim të evidentimit nëse Komisioni Disiplinor ka marrë për bazë vërejtjet e dhëna me rastin kur lëndën e ankuesit e kishte kthyer në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje përmes Vendimit A.nr.582/2022 dhe ka gjetur se Komisioni Disiplinor për dy raste të referuara ku është gjetur përgjegjës ankuesi, respektivisht ankuesi në cilësi të Udhëheqësit të Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte nuk i ka ndërmarr veprimet e nevojshme sipas të gjeturave Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 lidhur me inkasimin e borxheve të grumbulluara nga kompanitë: KRU "Prishtina" në vlerë 95,322.10€; KRU "Radoniqi-Dukagjini" në vlerë 31,022.24€ dhe KRU "Drini i Bardhë" 2,610.00€ të cilat nuk i kishin shlyer borxhin sipas marrëveshjeve, duke i shkaktuar kështu dëm buxhetit të Ministrisë në vlerë të përgjithshme prej 128,954€, si dhe për rastin ku ankuesi është gjetur përgjegjës për shkak të mos trajtimit brenda afatit të përcaktuar me nenin 98 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të kërkesës së datës 03.12.2019 të parashtruar nga operatori ekonomik "Ujë Rugove" SHPK, kanë qenë veprime të cilat janë kryer gjatë kohës sa

ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës dhe se dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk kanë fuqi retroaktive, mirëpo Kolegji vlerëson në rastin konkrete Komisioni Disiplinor këto të gjetura i ka përdorur për shkak se të njëjta kanë vazhduar të prodhojnë efekte apo kanë qenë aktuale edhe në momentin e inicimit të procedurës disiplinore dhe kanë shërbyer si rrethana arsyetuese me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, ndërsa Kolegji i Këshillit konstaton fakti se edhe sikurse të dyja shkeljet e evidentuara të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore sa ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, edhe sikur të hiqeshin nga përgjegjësia disiplinore e ankuesit, prap se prap veprimet e tjera të konstatuara si shkelje të rënda disiplinore në mënyrë komulative do të përbenin rrethanë dhe fakte të mjaftueshme që ankuesit t'i shqiptohej masa disiplinore "Largim nga shërbimi civil", andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e tërësishëm të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit si dhe pretendimet e t'i ankimore e parashtruara me datë 01.09.2022 në Këshill është e pabazuara, ndërsa vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 02.08.2022 është vendim i drejt dhe i ligjshëm dhe si i tillë ka mbetur në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.755/2022

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;;
- Arkivit të KPMSHCK-së